

Zyra për Informim

Raporti për konsultimin publik me qytetarë për: “Draft Statutin për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec”

Kronologji e shkurtër e konsultimit:

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17- Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Me 28/07/2021, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik për : “**Draft Statutin për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec**”, njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës në këtë vegëza: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/07/Njoftim-publik-pr-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Draft-Statutin-per-Qendren-Kryesore-te-Mjekesise-Familjare-ne-Rahovec.pdf> , Draft Statutin për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec është publikuar në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/07/Draft-Statuti-i-QKMF.pdf> .

Njoftimi dhe dokumenti janë publikuar edhe në Platformën e Konsultimeve Publike në këtë vegëza: <http://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41153> . Në të njëjtën datë njoftimi është publikuar në hyrje të objektit të administratës. Njoftimi dhe dokumenti i Statutit është publikuar në të dy gjuhët Shqip dhe Serbisht.

Më 11/08/2021 është planifikuar të mbahet konsultimi publik në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, por, nuk u mbajtë për shkak të mos pjesëmarrjes së asnjë qytetari e as ndonjë përfaqësuesi të OJQ-ve që veprojnë në komunën e Rahovecit.

Dokumenti i Draft Statutit të QKMF-së ka qenë në konsultim publik nga data: 28.07.2021 deri më: 28.08.2021, por, se në email-et e zyrtarëve që kanë qenë publik dhe që janë caktuar për t'i pranuar komentet apo edhe sugjerimet lidhur me këtë dokument, nuk është pranuar asnjë koment e as ndonjë sugjerim.

Pas përfundimit të të gjitha procedurave të konsultimit publik, dokumenti është dërguar në Ministri të Shëndetësisë dhe se dokumenti i njëjti nuk është kthyer nga ministria për të vazhduar me miratimin e tij nga anëtarët e Kuvendit Komunal.


Për t'i respektuar afatet ligjore jemi obliguar që të përgatisim dhe të publikojmë procesverbalin, kurse informatën shtesë që ka të bëjë me miratimin e Statutit do të publikojmë pasi që ky dokument të kalojë në Kuvend.

Me 24/09/2021 është publikuar procesverbali në uebfaqe zyrtare të komunës, procesverbalin mund ta gjeni të publikuara në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/09/Procesverbal-i-konsultimit-publik-per-Draft-Statutin-e-QKMF-se-ne-Rahovec.pdf>.

Tema	Zyra	Pjesëmarrës	Data Vendi	Komentet	1.Procesverbali
Draft Statutin për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	F 0 M 0	28/08/2021 Salla e mbledhjeve të Kuvendit	Nuk ka pasur asnjë koment lidhur me këtë dokument	1. https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/09/Procesverbal-i-konsultimit-publik-per-Draft-Statutin-e-QKMF-se-ne-Rahovec.pdf

Haziz Krasniqi

Zyrtar për Informim



24.09.2021